

Z. Berti Meçaj në vitin 1989 është diplomuar Oficer në degën Ndërlidhje, në “Akademinë Ushtarake Skënderbej”, Tiranë.

Gjithashtu në vitin 2009 është diplomuar për Financë në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Është i certifikuar si audit i brendshëm në sektorin publik, nga Ministria e Financave në vitin 2013.

Z. Meçaj është kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit prej muajit janar 2022.

Ka filluar punë në këtë institucion në vitin 2015 dhe deri në muajin janar 2022 ka kryer detyrën e audituesit.

Prej muajit shtator 2009 deri më mars 2015 ka punuar në sektorin privat dhe shtetëror si financiar.

Prej vitit 2004 deri në vitin 2007 ka punuar si inspektor në degën e Policisë Elektrike Tiranë - KESH ShA, ndërsa prej vitit 2007 deri në vitin 2009 si inspektor në Sektorin e Kontrollit të Energjisë Elektrike, pranë KESH Sh.A.

Prej vitit 1996 deri në vitin 2004 ka punuar në sektorin privat.

Në periudhën prej shtator 1989 deri në janar 1996, ka punuar si oficer ndërlidhës në Forcat e Armatosura të Ushtrisë.

Gjatë kohës që ka qenë i punësuar në KLSH, ka kryer disa trajnime dhe workshop-e brenda dhe jashtë vendit, të cilat lidhen me çështjet e auditimit publik, si pranë institucioneve homologe në Turqi, Poloni, Mali i zi etj, trajnime të organizuara në Shqipëri nga Agjencia Kombëtare Antikorrupsionit Italian, etj.